



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

Nr. _____ Prot.
2018

Tiranë, më ____.

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Lotin III “Blerje e aparatit GC për analizimin e gazeve për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”

Operatori ekonomik “KRIJON” shpk me adresë: Rruga “Todi Shkurti”, Nr 5/1, Shk.1, Ap.2 Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i referencës së lotit: REF-82675-08-10-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti III “Blerje e aparatit GC për analizimin e gazeve për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 7 336 700 (shtatë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH.

Afati i lëvrimit: 90 ditë nga lidhja e kontratës.

Publikime të mëparshme: *jo* Buletini i Njoftimeve Publike *nr. 33 datë 20 Gusht 2018*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1) O.E.S DISTRIMED

K31520054N

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 4,750.000 (katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*

2) KRIJON SHPK

K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 7.200.000 (shtatë milion e dyqind mijë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*

3) BIOMETRIC ALBANIA SHPK

J61827062E

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 5,487,000 (pesë milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*

4) TRINITY TRADE COMPANY SHPK

K81630026U

Emri i plotë i shoqërisë**numri i NIPT-it**

Vlera: 0 (zero) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **“TRINITY TRADE COMPANY” SHPK** me numër **K81630026U** nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
2. Operatori ekonomik **“BIOMETRIC ALBANIA” SHPK** me numër **J61827062E** me ofertë ekonomike 5.487.000 (pesë milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH.
 - *“Ofertuesi nuk plotëson specifikimet teknike të pajisjeve laboratorike: Gaz Kromatograf per percaktimin e hidrokarbureve te gazeve komerciale, të përcaktuara në shtojcën 10 të DT, sepse të dhënat teknike të katalogut të paraqitur në gjuhën shqipe nuk janë në përputhje me të dhënat teknike të kërkuara për këtë pajisje nga autoriteti kontraktor.”.*
3. Operatori ekonomik **“O.E.S DISTRIMED”** me numër **K31520054N** me ofertë ekonomike 4,750.000 (katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
 - *Për kushtet teknike janë kërkuar: “Detektor TCD, kit instalimi (ferrula, rakorderi, tub bakri, liner, shiringa, vialë, septa), filtra per pastrimin e te gjithë gazeve, Gjithashtu duhet te perfshihen tre kolona kapilare (2 te montuara + 1 rezerve + 1 Prekolone) te pershtatshme per aplikimin e kerkuar me gjatesi te pakten 25m secila, 2000 vialë 1.5 ose 2 ml, 5 shiringa per injektim, 20 liner si dhe softueri i kontrollit nga PC. Sistemi duhet te vije me metodika te instaluar ne fabrike si dhe dokumentacion specifik per aplikimin. Sistemi duhet te jete i pershtatur dhe i testuar per analizat e gazit sipas standartit EN 27941-95.” - ndërsa në katalog larmishmëria përcaktohet se ka tre dedektorë, tek pika 4 paragrafi i dytë “dedektorë opsionale” përcaktohet se do të pajisen në të ardhmen me këta dedektorë. Në katalog janë përfshirë vetem shiringa pa specifikuar të tjerat, mungojnë disa të dhëna dhe nuk është specifikuar as numri as përmasat e kolonave kapilare të kërkuara. Në katalog nuk përcaktohet nëse sistemi duhet të jetë i përshtatur me këtë standart.*
 - *Për furrën e kolonave janë kërkuar: “Temperatura maksimale e rampes (shpejtesise se rritjes se temperatures) të jetë të paktën 110°C/min”, por në katalog nuk është e specifikuar. Po ashtu është kërkuar “Ftohja e furrës nga 400°C ne 50°C të bëhet në më pak se 5 minuta.”, - ndërsa paisja e ofruar e realizon ftohjen në 5.5 minuta.*
 - *Për injektorin Split/Splitless janë kërkuar: “Diapazoni i presionit: jo me pak se 0-150 psi” - ndërsa në katalog është përcaktuar 0-100 psi; “Fluksi total: mbi 1500mL/min per He/H2” - ndërsa në katalog është përcaktuar 0-1000ml/min He; “Diapazoni i ndarjes (split range): nga 1 deri në të paktën 7000 në varësi të kolonës” - ndërsa në katalog është përcaktuar diapazoni i ndarjes së ofruar 7500, por nuk është specifikuar intervali.*
 - *Për kontrollin elektronik të fluksit janë kërkuar: “Presioni: me saktësi 0.1% Full Scale ose me te mire”, “Saktësia e sensorit te fluksit me e mire se 2% e matjes ose 0.2% full scale” dhe “Resolucioni i set point te presionit 0.001psi” - por në katalog nuk janë përcaktuar këto të dhëna teknike.*
 - *Për detektorin me jonizim të flakës (FID) janë kërkuar: “Temperatura maksimale jo me pak se 450°C” - ndërsa në katalog është përcaktuar 450°C ose me pak; “Shpejtesia e mbledhjes se te dhenave: mbi 480 Hz” - ndërsa në katalog është përcaktuar 200 Hz.*
 - *Për detektorin e konduktivitetit termik (TCD) është kërkuar: “Diapazoni dinamik linear: jo*

me pak se 100,000 (10⁵)” - por në katalog nuk janë përcaktuar të dhënat teknike për këtë parametër.

- *Për specifikimet e përgjithshme është kërkuar: “Ekran me prekje me madhësi të pakten 20cm” - ndërsa në katalog është përcaktuar 14,48 cm.*
- *Për komunikimin janë kërkuar: “Ethernet sipas protokollit TCP/IP”, “Data rate të pakten 100Mbps” dhe “Me 3 dalje analoge opsionale” - por në katalog nuk janë përcaktuar këto të dhëna teknike.*
- *Për kushtet e ambientit të punës janë kërkuar: “Temperatura: 10 deri 40 °C” dhe “Lageshtia relative: 5% deri 95%” - por në katalog nuk janë përcaktuar këto të dhëna teknike.*
- *Për softëware-in e sistemit të të dhënave kromatografike është kërkuar: “Të kete mundësi integrimin në LIMS. Softueri të jete i pershtatshem per laboratore te jane te detyruar te funksionojne ne perputhje me ISO/IEC 17025.” - por në katalog nuk janë përcaktuar këto të dhëna teknike.”*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “KRIJON” shpk me adresë: Rruga “Todi Shkurti”, Nr 5/1, Shk.1, Ap.2 Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **7.200.000** (shtatë milion e dyqind mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor, **Drejtoria e Përgjithshme të Doganave**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, menjëherë nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do të anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **11.10.2018**

Ankesa: **Po.**

U paraqit ankesa me nr.947prot. datë 28.09.2018 nga operatori ekonomik “KRIJON shpk” në lidhje me kualifikimin e ofertuesit “O.E.S Distrimed shpk”. Procedura u pezullua deri në marrjen e një vendimi në lidhje me ankesën. Me shkresën nr.947/1prot. datë 04.10.2018 “Kthim përgjigje”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në organin qendror blerës mori vendim për pranimin e ankesës së ofertuesit “KRIJON shpk” dhe s’kualifikimin e operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed shpk”, prandaj kjo procedurë kaloi për rivlerësim nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me datë 11.10.2018

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**